4.Numri i referencës së procedurës/lotit REF-82508-12-17-2020

5.Fondi i Marrveshjes Kuader per 12 muaj – 1,660,374 (*nje milion e gjashteqind e gjashtedhjete mije e treqind e shtatedhjete e kater*) leke pa tvsh

6. Kohëzgjatja e Marrveshjes Kuader: 12 muaj

7- Afati kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:
Data: 29/12/2020 Ora: 10:00

8- Afati kohor për hapjen e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:
Data: 29/12/2020 Ora: 10:00

AGJENCIA E BLERJEVE TË PËRQENDRUARA

1. Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor

Emri	Agjencia e Blerjeve të Përqendruara
Adresa	Sheshi Skënderbej, nr. 3, Tiranë
E-mail	Anisa.Bogdani@mb.gov.al
Faqja në Internet	www.abp.gov.al
Personi pergjegjes:	Anisa BOGDANI

2. Lloji i procedurës se prokurimit: "Kërkesë për propozim" – Marrëveshjes Kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, me afat të Marrëveshjes Kuadër 24 (njëzet e katër) muaj.

3. Objekti i kontratës/marrëveshjes kuadër: "Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Drejtorinë Vendore të Policisë Durrës"

4. Numri i referencës së procedurës: REF-82542-12-17-2020

5. Fondi limit: 2.600.000 (dy milion e gjashtëqindmije) leke pa TVSH;

6. Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin: Duke filluar nga data e lidhjes së kontratës/kontratave me përfundim deri në plotësimin e nevojave të autoritetit kontraktor, sipas marrëveshjes kuadër.

7- Afati kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje: Data 28.12.2020 (dd/mm/vvvv), Ora: 12:00, Vendi: www.app.gov.al

8- Afati kohor për hapjen e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje: Data 28.12.2020 *(dd/mm/vvvv),* Ora: 12:00, Vendi : Ministria e Brendshme, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.

PROCEDURA SHËRBIM KONSULENCE

PROCEDURA NEGOCIIM ME SHPALLJE PARAPRAKE TË NJOFTIMIT TË KONTRATËS

NJOFTIME FITUESI ME PROKURIM ELEKTRONIK

NJËSIA VENDORE E KUJDESIT SHËNDETËSOR DURRËS

Për:"KRIJON" Shpk me NIPT K12023001A me Adrese Tirane Farke FARKE Rruga e Elbasanit, nr.57, Çollak, 1044

Procedura e prokurimit: Kerkese per Propozim

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-73675-10-01-2020

Përshkrim i shkurtër i kontratës: Kite Reagente per Laboratoret e Shendetit Publik

Fondi limit:2,500,000 (Dymilionepeseqindmije) leke pa TVSH
Kohezgjatja e kontrates :Nga lidhja e kontrates deri me date 31.12.2020
Publikime të mëparshme *nuk ka:* Buletini i Njoftimeve Publike *[Data] [Numri]*
Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët x oferta ekonomikisht më e favorshme □
Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:
1." KRIJON" Shpk me NIPT K12023001A
_____ _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*
Vlera 2,148,880 (dymilionenjeqindedyzetetetemijeeteteqindetetedhjete;)Lek pa TVSH
(me numra dhe fjalë)

2." BIOMEDICA ALBANIA DISTRIBUTION" Shpk me NIPT L52020002V
_____ _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*
Vlera 2,274,000 (Dymilionedyqindeshtatedhjeteekatermije)Lek pa TVSH
(me numra dhe fjalë)
Etj._____

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:
1." BIOMEDICA ALBANIA DISTRIBUTION" Shpk me NIPT L52020002V
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme: Oferta e paraqitur nuk eshte ne perputhje me te gjitha kerkesat dhe specifikimet e percaktuara ne njoftimin e kontrates dhe ne dokumentat e tenderit.

Sipas Vendimit Nr.550/2020 date 04.12.2020 te Komisionit te Prokurimit Publik

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë ." KRIJON" Shpk me NIPT K12023001A se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 2.148.880

(dymilionenjeqindedyzetetetemijeeteteqindetetedhjete) Lek pa TVSH *]*/pikët totale të marra *[_____]*është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *[Njesia Vendore e Kujdesit Shendetesor Durres kati III –te prane personit pergjegjes Frosida Gjeçit]* sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5(pese) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej *[vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]*, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 22.10.2020

Ankesa: ka ose jo ka
(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë 02.11.2020

BASHKIA LEZHË

Për: Operatorin Ekonomik STELLA Shpk, me adrese Lagjja Nen Tereza, godina ne rrugen nacionale Lezhe- Shkoder km 1, Lezhe.

Procedura e prokurimit: Kerkese per Propozime/ Mallra

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-78843-11-16-2020

Përshkrim i shkurtër i kontratës: "Blerje kabulli elektrik per rikualifikimin e ndriçimit rrugor ne qytetin e Lezhes".
Kohëzgjatja e kontratës: 5 (pese) dite nga data e nënshkrimit te kontratës.
Publikime të mëparshme *(nëse zbatohet):* Buletini i Njoftimeve Publike *[Data] [Numri]*
Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X oferta ekonomikisht më e favorshme □

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1- Operatori Ekonomik "DRINI A" Shpk, me NUIS J67902505V, me oferte ekonomike 3,997,640 (tremilion e nenteqind e nentedhjetë e shtate mije e gjashteqind e dyzet) Lek pa Tvsh.

2- Operatori Ekonomik "EDICO GROUP" Shpk, me NUIS L82118039C, me oferte ekonomike 3,999,615 (tre milion e nenteqind e nentedhjetë e nente mije e gjashteqind e pesembedhjete) Lek pa Tvsh.

3- Operatori Ekonomik "ELECTRIC SYSTEM ALBANIA" Shpk, me NUIS L41306091M, me oferte ekonomike 4,020,565 (kater milion e njëzet mije e peseqind e gjashtëdhjetë e pese) Lek pa Tvsh.

4- Bashkimi i Operatoreve Ekonomik "FREDI ELECTRONIC" Shpk, me NUIS K91803020F & "SIRETA 2F" Shpk, me NUIS K51501008J, me oferte ekonomike 3,584,200 (tre milion e peseqind e tetedhjetë e kater mije e dyqind) Lek pa Tvsh.

5- Operatori Ekonomik "HEST" Shpk, me NUIS L21527009H, me oferte ekonomike 3,703,805 (tre milion e shtateqind e tre mije e teteqind e pese) Lek pa Tvsh.

6- Operatori Ekonomik "KLOSI-R COMPANY" Shpk, me NUIS L72120030I, me oferte ekonomike 2,803,170 (dy milion e teteqind e tre mije e njeqind e shtatedhjete) Lek pa Tvsh.

7- Operatori Ekonomik "LUAR Bros" Shpk, me NUIS L72322004M, me oferte ekonomike 3,446,650 (tre milion e katerqind e dyzet e gjashte mije e gjashteqind e pesedhjete) Lek pa Tvsh.

8- Operatori Ekonomik "STELLA" Shpk, me NUIS J87603505T, me oferte ekonomike 3,239,140 (tre milion e dyqind e tridhjete e nente mije e njëqind e dyzet) Lek pa Tvsh.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1- Operatori Ekonomik "EDICO GROUP" Shpk, me NUIS L82118039C.

2- Operatori Ekonomik "ELECTRIC SYSTEM ALBANIA" Shpk, me NUIS L41306091M.

3- Operatori Ekonomik "HEST" Shpk, me NUIS L21527009H.

4- Operatori Ekonomik "KLOSI-R COMPANY" Shpk, me NUIS L72120030I.

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

I- Operatori ekonomik "EDICO GROUP" Shpk, me NUIS L82118039C

Nga Verfikimi ne SPE rezulton se Operatori Ekonomik nuk plotëson kriteret e veçanta te kualifikimit te vendosur ne DST konkretisht:

2. Në shtojcën 8, pika 2/1 b "Kriteret e Vecanta të Kualifikimit", parashikohet se OE duhet te dorezoje:

b. Deklaratën për paraqitje oferte të pavarur sipas Shtojcës 2/1;

KVO gjate verifikimit ne SPE konstatoi se per shtojcen 2/1 OE nuk ka shenuar asnje nga opsionet nese:

a)Ofertuesi ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër;

b)Ofertuesi është konsultuar, ka komunikuar, ka bërë marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet bashkangjitur, në detajet e kësaj oferte, janë përfshirë emrat e konkurrentëve, natyra dhe shkaqet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes apo angazhimit (rasti i bashkimit të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit).

Si rrjedhoje e kësaj KVO nuk ka informacion mbi mënyrën e paraqitjes se ofertës ne menyre te pavarur apo eshte konsultuar me OE te tjere.

Vlen te theksohet se mos shënimi i asnjë prej opsioneve e ben kete shtojce te pavlefshme sepse nuk jepet informacioni per te cilën eshte miratuar kjo shtojce nga autoritetet përkatëse.

Nisur nga konstatimet e mësipërme, KVO vlerëson se OE nuk plotëson kete kriter te vendosur ne DST.

Ne lidhje me plotesemin e pikes 2.1/dh parashikohet se:
OE duhet te paraqesë vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.
Nga verifikimi i dokumentacionit ne SPE, rezulton se OE ka paraqitur vërtetimin qe ka shlyer detyrimin e energjisë elektrike per muajin Gusht 2020. Publikimi i njoftimit te kontratës nga ana e AK-se eshte bere me date 17.11.2020, duke bere qe muaji i maturuar per shlyrjen e energjisë elektrike te jete muaji shtator 2020, rrjedhimisht KVO vlerëson se bazuar ne dokumentacionin e ngarkuar ne SPE nga ana Operatorit Ekonomik, ka detyrime te papaguara te energjisë elektrike.

Ne lidhje me piken 2.3.2/c parashikohet se:
Për të provuar se ka përvoje e duhur, operatori duhet të dëshmoje se ka të punësuar mesatarisht të paktën 3 (tre) punonjës, për periudhën Prill 2020 – shtator 2020 të dëshmuar me;
a. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj në periudhën e mësipërme.
b. List-pagesat e punonjësve të plotësuar rregullisht sipas formatit e percaktimeve qe kerkohet nga legjislacioni ne fuqi per secilin nga muajt ne periudhen e mesiperme.
c. Të ketë në stafin e punonjesve të paktën:
- Shofer - 1

Per punonjësit e sipërpërmendur të paraqiten:
- Lejet e drejtimit per shoferet,
- kontratat e punës të vlefshme.
- Libreze Pune
- Punonjesit e mësipërm te figurojne ne listepagesat e shoqerise te pakten 6 muajt e fundit.

Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se OE nuk ka paraqitur dekumentacion qe provon disponueshmerine e shoferit. Konkretisht nuk eshte paraqitur Leja e drejtimit, kontrata e punes dhe libreza e punes.

Ne lidhje me piken 2.3.6 ku parashikohet se:
Për mallrat sipas pikes 2.3.5 te DST-se operatori ekonomik duhet të dorëzojë Autorizim/Marrëveshje me prodhuesin/distributorin e autorizuar.
Nga verifikimi i dokumentacionit te ngarkuar ne SPE rezulton se OE nuk ka paraqitur dokument qe vërteton plotësimin e kësaj pike.

Sa me siper Komisioni i vleresimit te ofertave mbeshtetur në nenin 46, pika 1 gërma "b" të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, ku parashikohet shprehimisht se: "Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e

objektit të kontratës;" si dhe ne në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, ku parashikohet: "Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit" vendosi te refuzoje oferten e "EDICO GROUP" Shpk, per mospermbushje te kritereve te vecanta kualifikuese.

Si perfundim, në mbështetje të nenit 46, 53, 54 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik". të ndryshuar, Operatoreri Ekonomik "EDICO GROUP" Shpk, *skualifikohet.*

II- Operatori ekonomik "ELECTRIC SYSTEM ALBANIA" Shpk, me NUIS L41306091M
Nga Verfikimi ne SPE rezulton se Operatori Ekonomik nuk plotëson kriteret e veçanta te kualifikimit te vendosur ne DST konkretisht:

Në shtojcën 8, pika 2/1 b "Kriteret e Vecanta të Kualifikimit", parashikohet se OE duhet te dorezoje:
b. Deklaratën për paraqitje oferte të pavarur sipas Shtojcës 2/1;

KVO gjate verifikimit ne SPE konstatoi se per shtojcen 2/1 OE nuk ka shenuar asnje nga opsionet nese:
a)Ofertuesi ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër;
b)Ofertuesi është konsultuar, ka komunikuar, ka bërë marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet bashkangjitur, në detajet e kësaj oferte, janë përfshirë emrat e konkurrentëve, natyra dhe shkaqet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes apo angazhimit (rasti i bashkimit të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit).

Si rrjedhoje e kësaj, KVO nuk ka informacion mbi mënyrën e paraqitjes se ofertës ne menyre te pavarur apo eshte konsultuar me OE te tjere. Vlen te theksohet se mos shënimi i asnjë prej opsioneve e ben kete shtojce te pavlefshme sepse nuk jepet informacioni per te cilën eshte miratuar kjo shtojce nga autoritetet përkatëse. Nisur nga konstatimet e mësipërme KVO vlerëson se OE nuk plotëson kete kriter te vendosur ne DST.

Ne lidhje me piken 2.3.6 ku parashikohet se:
Për mallrat sipas pikes 2.3.5 te DST-se operatori ekonomik duhet të dorëzojë Autorizim/Marrëveshje me prodhuesin/distributorin e autorizuar.

Nga verifikimi ne SPE rezulton se OE ka paraqitur nje dokumentacion me titull "Deklarate Distribucioni". Pas hapjes se këtij dokumenti rezulton se gjuha e përdorur per hartimin e këtij dokumenti eshte ne Anglisht, i pa përkthyer ne gjuhen Shqipe.

Sa me sipër bazuar ne Seksionin 4, "Procedura", pika 4.6 te DST-se, parashikohet se gjuha qe kërkohet nga AK per hartimin e ofertës per kete procedure prokurimi eshte gjuha Shqipe. Rrjedhimisht ky dokumentacion nuk eshte paraqitur sipas formës se kërkuar ne DST.

Sa me siper Komisioni i vleresimit te ofertave mbeshtetur në nenin 46, pika 1 gërma "b" të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, ku parashikohet shprehimisht se:

"Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;" si dhe ne në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, ku parashikohet: "Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit" vendosi te refuzoje oferten e "ELECTRIC SYSTEM ALBANIA" Shpk per mospermbushje te kritereve te vecanta kualifikuese.

Sa më sipër, në mbështetje të nenit 46, 53, 54 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar, Operatori Ekonomik "ELECTRIC SYSTEM ALBANIA" Shpk, *skualifikohet*.

III- Operatori Ekonomik "HEST" Shpk, me NUIS L21527009H

Nga Verfikimi ne SPE rezulton se Operatori Ekonomik nuk plotëson kriteret e veçanta te kualifikimit te vendosur ne DST konkretisht:

Ne lidhje me piken 2.3.2/ c parashikohet se:

Për të provuar se ka përvoje e duhur, operatori duhet të dëshmoje se ka të punësuar mesatarisht të paktën 3 (tre) punonjës, për periudhën Prill 2020 – shtator 2020 të dëshmuar me;

b. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj në periudhën e mësipërme.

b. List-pagesat e punonjësve të plotësuar rregullisht sipas formatit e percaktimeve qe kerkohet nga legjislacioni ne fuqi per secilin nga muajt ne periudhen e mesiperme.

c. Të ketë në stafin e punonjesve të paktën:

- Shofer - 1

Per punonjësit e sipërpërmendur të paraqiten:

- Lejet e drejtimit per shoferet,
- kontratat e punës të vlefshme.
- Libreze Pune
- Punonjesit e mësipërm te figurojne ne listepagesat e shoqerise te pakten 6 muajt e fundit.

Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se OE ka paraqitur kontrate pune me punemarresin Z. Dritan Beshaj, i cili eshte punesuar prane kesaj kompanie si Agjent tregtar dhe shofer i kompanise, por ne SPE nuk eshte ngarkuar dokumentacion qe provon qe punemarresi I sipercituar disponon Leje Drejtimi sipas parashikimeve te kesaj pike ne DST.

Sa me siper Komisioni i vleresimit te ofertave mbeshtetur në nenin 46, pika 1 gërma "b" të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, ku parashikohet shprehimisht se: "Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e

nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;" si dhe ne në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, ku parashikohet: "Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit" vendosi te refuzoje oferten e OE "HEST" Shpk per mospermbushje te kritereve te vecanta kualifikuese.

Sa më sipër, në mbështetje të nenit 46, 53, 54 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar, Operatori Ekonomik "HEST" Shpk, *skualifikohet*.

IV- Operatori ekonomik "KLOSI-R COMPANY" Shpk, me NUIS L72120030I.
Nga Verfikimi ne SPE rezulton se Operatori Ekonomik nuk plotëson kriteret e veçanta te kualifikimit te vendosur ne DST konkretisht:

Ne lidhje me piken 2.3.6, ku parashikohet se:
Për mallrat sipas pikes 2.3.5 te DST-se operatori ekonomik duhet të dorëzojë Autorizim/Marrëveshje me prodhuesin/distributorin e autorizuar.

Nga verifikimi ne SPE rezulton se OE, ka paraqitur nje dokumentacion me titull *"autorizim prodhuesi dhe skeda teknike HASCELIK"*, por pas hapjes se këtij dokumenti rezulton nje kontrate qiraje per automjetin me targe AA138IO dhe jo dokumentacioni i kërkuar nga AK. Per rrjedhoje Operatori Ekonomik nuk provon se disponon autorizim prodhuesi per produktet e kërkuara.

Ne lidhje me piken 2.3.7 ku parashikohet se:
Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklarate me anë të së cilës merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit të gjithe artikujve të përfshira në këtë procedure prokurimi.

Nga verifikimi ne SPE rezulton se OE ka paraqitur nje dokumentacion me titull "Deklerate", por pas hapjes se këtij dokumenti rezulton nje deklerate per tenderin me objekt: "Blerje gjenerator për serverat e INSTAT", i cili nuk ka lidhje me objektin e tenderit te shpallur nga AK Bashkia Lezhe. Rrjedhimisht OE nuk ka paraqitur nje deklerate me anë të së cilës merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit të gjithe artikujve të përfshira në këtë procedure prokurimi duke mos plotesuar kriterin 2.3.7.

Sa me siper Komisioni i vleresimit te ofertave mbeshtetur në nenin 46, pika 1 gërma "b" të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, ku parashikohet shprehimisht se: "Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;" si dhe ne në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, ku parashikohet: "Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të

këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit" vendosi te refuzoje oferten e OE "KLOSI-R COMPANY" Shpk per mospermbushje te kritereve te vecanta kualifikuese.

Si perfundim në mbështetje të nenit 46, 53, 54 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar, Operatorevi Ekonomik "KLOSI-R COMPANY" Shpk, *skualifikohet.*

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin Ekonomik STELLA Shpk, me adrese Lagjja Nen Tereza, godina ne rrugen nacionale Lezhe- Shkoder km 1, Lezhe se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 3,239,140 (tre milion e dyqind e tridhjete e nente mije e njëqind e dyzet) Lek pa Tvsh është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkise Lezhe dokumentat e noterizuara dhe sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pese) pese ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej *[vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]*, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 03/12/2020
Ankesa: Nuk Ka

BASHKIA ELBASAN

Nga: Bashkia Elbasan adresa: rruga "Qemal Stafa", Elbasan.

Për "NIKA" sh.p.k me adresë: Shkodër, Lagjja Vasil Shanto, Bulevardi Skenderbeu, godine 8-katëshe, kati i I-re

Procedura e prokurimit: "Kërkesë për propozim".

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-78320-11-11-2020

Përshkrim i shkurtër i kontratës: "Rehabilitimi i sheshit para pallatit 108/1 (lulishte midis rrugëve Q.Stafa dhe unazës perëndimore)" me fond limit: 4,640,884 (katërmilion e gjashtëqind e dyzetëmijë e tetëqind e tetëdhjetë e katër) lekë pa t.v.sh, vënë në dispozicion nga Buxheti i Bashkisë Elbasan për vitin 2020, dhe me afat për kryerjen e punimeve 2 muaj nga data e lidhjes së kontratës.
Publikime të mëparshme *(nëse zbatohet):* Buletini i Njoftimeve Publike *[data] [nr]*
Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X oferta ekonomikisht më e favorshme□

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në proçedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. "NIKA" sh.p.k me Nipt: J 76705047 U
Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është 3,311,885 (tremilion e treqind e njëmbëdhjetë mijë e tetëqind e tetëdhjetë e pesë) lekë (pa tvsh) dhe me vlerë kontrate prej 3,974,262 (tremilion e nëntëqind e shtatëdhjetë e katërmijë e dyqind e gjashtëdhjetë e dy) lekë (me tvsh)

2. "Bajrami-N" Sh.p.k me nipt K 02727202 O
Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është 3.872.806,2 (tremilion e tetëqind e shtatëdhjë e dymijë e tetëqind e gjashtë presje dy) lekë (pa tvsh) dhe me vlerë kontrate prej 4.647.367,4 (katërmilion e gjashtëqind e dyzet e shtatëmijë e treqind e gjashtëdhjetë e shtatë presje katër) lekë (me tvsh)

3. "SARK" Sh.p.k me nipt K 52531415 H
Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është 4.014.844 (katërmilion e katërmbëdhjetëmijë tetëqind e dyzet e katër) lekë (pa tvsh) dhe me vlerë kontrate prej 4.817.812 (katërmilion e tetëqind e shtatëmbëdhjetëmijë e tetëqind e dymbëdhjetë) lekë (me tvsh)

4. "RAFIN COMPANY " Sh.p.k me nipt L 52125110 A
Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është 4.179.848,2 (katërmilion e njëqind e shtatëdhjetë e nëntëmijë e tetëqind e dyzet e tetë presje dy) lekë (pa tvsh) dhe me vlerë kontrate prej 5.015.817,8 (pesëmilion e pesëmbëdhjetëmijë tetëqind e shtatëmbëdhjetë presje tetë) lekë (me tvsh)

Duke iu referuar proçedurës së lartpërmendur, informojmë subjektin: "NIKA" sh.p.k me adresë: Shkodër, Lagjja Vasil Shanto, Bulevardi Skenderbeu, godine 8-katëshe, kati i I-re, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 3,311,885 (tremilion e treqind e njëmbëdhjetë mijë e tetëqind e tetëdhjetë e pesë) lekë (pa tvsh), është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni të lutur të paraqisni pranë Bashkisë Elbasan (Drejtoria e Prokurimeve Publike), sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pese) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, autoriteti kontraktor do të anullojë procedurën, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Njoftimi i klasifikimit është bërë në datë: 1.12.2020
Ankesa nuk ka pasur.

BASHKIA ELBASAN

Nga: Bashkia Elbasan adresa: rruga "Qemal Stafa", Elbasan.

Për: "Hest" sh.p.k me adresë: Bulevardi Gjergj Fishta, Blloku 1 /Ap 1.

Procedura e prokurimit: "Kerkese per Propozim".

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-78336-11-11-2020

Përshkrim i shkurtër i kontratës: "Blerje shtylla për linjat elektrike të ndriçimit rrugor" me fond 1,311,140 (njëmilion e treqind e njëmbëdhjetëmijë e njëqind e dyzet) lekë pa t.v.sh. , vënë në dispozicion nga Buxheti i Bashkisë Elbasan për vitin 2020, me afat për lëvrimin e mallit 20 ditë nga momenti i lidhjes se kontratës.
Publikime të mëparshme *(nëse zbatohet):* Buletini i Njoftimeve Publike *[Data] [Numri]*
Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X oferta ekonomikisht më e favorshme □

Njoftojmë se, kane qene pjesemarres ne procedure keta ofertues me vlerat perkatese te ofruara:
1. "Hest" sh.p.k me Nipt L 21527009 H
Vlera e paraqitur në këtë procedurë është 859.500 (tetëqind e pesëdhjete e nëntëmijë e peseqind) lekë (pa tvsh) dhe me vlerë kontrate prej 1.031.400 (njëmilion e tridhjetë e njëmijë e katërqind) lekë (me tvsh).

2. "Zeqiri" sh.p.k me Nipt J 67902827 A
Vlera e paraqitur në këtë procedurë është 965.000 (nëntëqind e gjashtëdhjetë e pesëmijë) lekë (pa tvsh) dhe me vlerë kontrate prej 1.158.000 (njëmillion e njëqind e pesëdhjetë e tetë mijë) lekë (me tvsh).

3. "Luar Bros" sh.p.k me Nipt L 72322004 M
Vlera e paraqitur në këtë procedurë është 989.500 (nëntëqind e tetëdhjetë e nëntëmijë e pesëqind) lekë (pa tvsh) dhe me vlerë kontrate prej 1.187.400 (njëmilion e njëqind e tetëdhjetë e shtatëmijë e katërqind) lekë (me tvsh).

4. "Rafin Company" sh.p.k me Nipt L 52125110 A
Vlera e paraqitur në këtë procedurë është 1.286.000 (njëmilion e dyqind e tetëdhjetë e gjashtëmijë) lekë (pa tvsh) dhe me vlerë kontrate prej 1.543.200 (njëmilion e pesëqind e dyzet e tremijë e dyqind) lekë (me tvsh).

Ofertues te skualifikuar nuk ka pasur.

Në vendin e parë klasifikohet ofertuesi "Hest" sh.p.k për çmimin prej 859.500 (tetëqind e pesëdhjete e nëntëmijë e peseqind) lekë (pa tvsh) dhe me vlerë kontrate prej 1.031.400 (njëmilion e tridhjetë e njëmijë e katërqind) lekë (me tvsh), si oferta më e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkise Elbasan (Drejtoria e Prokurimeve), sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pese) ditëve nga dita e marrjes/publikimit së këtij njoftimi.
Njoftimi i klasifikimit është bërë në datë: 1.12.2020
Ankesa nuk ka pasur.

DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR LEZHË

Për: *SOFIA MYFTARI PERSON FIZIK ME NUMER NIPTI* K42611766Q
Adresa: GJIROKASTER GJIROKASTER GJIROKASTER LAGJIA 18 SHTATORI, GODINE NJE KATESHE PERBALL ME FAKULTETIN EKONOMIK

Procedura e prokurimit: Kërkesë për propozim

Numri i referencës së procedurës: REF-77153-10-30-2020

Përshkrim i shkurtër i kontratës: Blerje shkumesi per shkollat per shkollat qe jane ne juridiksion te DRAP Lezhe
Publikime të mëparshme *(nëse zbatohet):* Buletini i Njoftimeve Publike *Datë 9 nëntor 2020 nr 99*
Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X oferta ekonomikisht më e favorshme □

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:
1. FERIT MYFTARI PERSON FIZIK K32508611I
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*
Vlera *1 350 150 (Një milion e treqind e pesëdhjet mijë e njëqind e pesëdhjetë) lek pa TVSH*
(me numra dhe fjalë)

2.MIEFEL SHPK L82916601N
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*
Vlera *1 557 500 (Një milion e pesëqind e pesëdhjet e shtatë mijë e pesëqind) lek pa TVSH*
(me numra dhe fjalë)
3.SOFIA MYFTARI PERSON FIZIK K42611766Q
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*
Vlera *1 737 500 (Një milion e shtatëqind e tridhjet e shtatë mijë e pesëqind) lek pa TVSH*
Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:
1. FERIT MYFTARI PERSON FIZIK K32508611I
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*
2. MIEFEL SHPK L82916601N
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

1. FERIT MYFTARI PERSON FIZIK K32508611I

- Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga ana e Juaj në ofertë rezulton se Ju jeni i njëjti person me përfaqësuesin ligjor të Operator ekonomik MIEFEL SHPK me NIPT L82916601N. Në zbatim të nenit nr 65 të VKM nr 914 datë 29.12.2019 "Për miratimin e rregullave të prokurimit Publik" të ndryshuar Ju skualifikoheni për arsye se pjesëmarrja nga një ofertues në më shumë se një ofertë, tek e tek ose me një ofertues tjetër, do të rezultojë në përjashtimin nga procesi të të gjitha ofertave, në të cilat është përfshirë ofertuesi.
- Gjithashtu Ju nuk keni paraqitur mostrat për mallrat e kërkuara në datën e zhvillimit të proçedurës së prokurimit.

2. MIEFEL SHPK L82916601N

- Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga ana e Juaj në ofertë rezulton se Ju jeni i njëjti person me përfaqësuesin ligjor të Operator ekonomik Ferit Myftari Person Fizik me NIPT K32508611I. Në zbatim të nenit nr 65 të VKM nr 914 datë 29.12.2019 "Për miratimin e rregullave të prokurimit Publik" të ndryshuar Ju skualifikoheni për arsye se pjesëmarrja nga një ofertues në më shumë se një ofertë, tek e tek ose me një ofertues tjetër, do të

rezultojë në përjashtimin nga procesi të të gjitha ofertave, në të cilat është përfshirë ofertuesi.

- Gjithashtu Ju nuk keni paraqitur mostrat për mallrat e kërkuara në datën e zhvillimit të proçedurës së prokurimit.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë SOFIA MYFTARI PERSON FIZIK me NIPT K42611766Q se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej *[shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]*/pikët totale të marra *1 737 500 (Një milion e shtatëqind e tridhjet e shtatë mijë e pesëqind) lek pa TVSH* është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Lezhë* sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 10 (Dhjetë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.
Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, proçedura do të anullohet siç parashikohet në nenin Ligjin nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.
Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 24/11/2020
Ankesa: Ankesa nuk ka
(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

OPERATORI I SISTEMIT TË TRANSMETIMIT (OST SH.A.)

Nga: Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST sh.a.)

Adresa: Tiranë, Kashar, Yrshek, Autostrada Tiranë-Durrës, Km. 9
Kontakt: www.ost.al; e-mail: info@ost.al.

Për: OE "Instituti Dekliada – ALB" sh.p.k., me NIPT K71606006A
Adresa: Njesia Bashkiake Nr. 5, Rruga "Milto Tutulani", ndertesa 4, hyrja 10, apartamenti 6, 1019, Tiranë.

Procedura e prokurimit: "Kërkesë për propozim" - me mjete elektronike – Shërbime

Numri i referencës i procedurës: REF-78240-11-11-2020

Përshkrim i shkurtër i kontratës: "VNM paraprake dhe VNM e thelluar për projektin "Programi i eficencës së Energjisë të Sektorit të Transmetimit".

Kohëzgjatja e kontratës: 3 (tre) muaj nga hyrja në fuqi e kontratës.

Publikime të mëparshme *(nëse zbatohet):* Buletini i Njoftimeve Publike, Datë 16.11.2020, Nr. 101.
Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët.
Fondi Limit: 1,000,000 (një milion) Lekë pa TVSH, nga të ardhurat e OST sh.a.
Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: Datë 23.11.2020.

Njoftojmë se, kanë qenë pjesemarrës në procedurë 4 (katër) ofertues, me vlerat përkatëse të ofruara:

1. OE "Instituti Dekliada - ALB" sh.p.k. me NIPT K71606006A
   me ofertë ekonomike 751,000 (shtatëqind e pesëdhjetë e një mijë) Lekë pa TVSH.

2. BOE "Green Eagle Consulting" sh.p.k. me NIPT L81603023A
   "Zenit&CO" sh.p.k. me NIPT K61731002D
   "Transport Highway Consulting" sh.p.k. me NIPT K51428048I
   me ofertë ekonomike 890,000 (tetëqind e nëntëdhjetë mijë) Lekë pa TVSH.
3. OE "Taulant" sh.p.k. me NIPT K61617040L
   me ofertë ekonomike 899,000 (tetëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë) Lekë pa TVSH.
4. OE "Sazan Guri" Person Fizik me NIPT K62101007P
   me ofertë ekonomike 900,000 (nëntëqind mijë) Lekë pa TVSH.

Nuk janë kualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. BOE "Green Eagle Consulting" sh.p.k. me NIPT L81603023A & "Zenit&CO" sh.p.k. me NIPT K61731002D & "Transport Highway Consulting" sh.p.k. me NIPT K51428048I, per arsye se:

- Nuk ka përmbushur kriterin 1/b të Kritereve të Vecanta të Kualifikimit, pasi asnjëri nga anëtarët e BOE nuk ka plotësuar Deklaratë për paraqitje oferte të pavaruar, Shtojca 1/1.
- Nuk ka përmbushur kriterin 2.3.7 të Kritereve të Vecanta të Kualifikimit, pasi nuk ka deklaruar të dhënat e kërkuara për verifikimin e gjendjes gjyqësore.

2. OE "Taulant" sh.p.k., me NIPT K61617040L, për arsye se:

- Nuk ka përmbushur kriterin 1/b të Kritereve të Vecanta të Kualifikimit, pasi nuk ka plotësuar Shtojca 1/1 "Deklaratë për paraqitje oferte të pavaruar".
- Nuk ka përmbushur pikën 1 të Kritereve të Përgjithshme të Kualifikimit, pasi nuk ka plotësuar Shtojcën 4 "Deklaratë mbi përmbushjen e kritereve të përgjithshme".
- Nuk ka përmbushur pikën 1/c të Kritereve të Përgjithshme të Kualifikimit, pasi nuk ka plotësuar Shtojcën 4/1 "Deklaratën mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës".
- Nuk ka përmbushur pikën 1/ç të Kritereve të Përgjithshme të Kualifikimit, pasi nuk ka plotësuar Shtojcën 5 "Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike".
- Nuk ka përmbushur pikën 1/d të Kritereve të Përgjithshme të Kualifikimit, pasi nuk ka plotësuar Shtojcën 6 "Deklaraten mbi Konfliktin e Interesit".
- Nuk ka përmbushur kriterin 2.3.7 të Kritereve të Vecanta të Kualifikimit, pasi nuk ka deklaruar të dhënat e kërkuara për verifikimin e gjendjes gjyqësore.

3. OE "Sazan Guri" Person Fizik, me NIPT K62101007P, për arsye se:

- Nuk ka përmbushur pikën 1/dh, të Kritereve të Përgjithshme të Kualifikimit, pasi nuk ka paraqitur Vërtetim nga OSHEE për shlyerjen e të gjithë detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike, sipas formatit zyrtar të autorizuar nga shpërndarësi i energjisë për vërtetim debie.
- Nuk ka përmbushur kriterin 2.3.1, të Kritereve të Përgjithshme të Kualifikimit, pasi fatura tatimore e paraqitur nuk është nënshkruar nga Blerësi, sipas kërkesës së DST. Gjithashtu, fatura e paraqitur është e palexueshme përshkrimin e objekti të saj.
- Nuk ka përmbushur kriterin 2.3.3 të Kritereve të Përgjithshme të Kualifikimit, pasi nuk ka vërtetuar se OE ofertues ka eksperiencë në hartimin e raporteve të Vlerësimit të Ndikimit te Mjedis jo më pak se 2 vjet.
- Nuk ka përmbushur kriterin 2.3.5 të Kritereve të Përgjithshme të Kualifikimit, pasi nuk ka paraqitur dokumentacion nëse OE ofertues ka të punesuar një ekspert për auditim enerergjie,

të vertetuar me certefikatë lëshuar nga AEE dhe të figurojnë në lispagesën e të paktën 3 muajve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit.

- Nuk ka përmbushur kriterin 2.3.6 të Kritereve të Përgjithshme të Kualifikimit, pasi nuk ka paraqitur dokumentacion për të vërtetuar nëse ka eksperiencë në hartimin e raporteve të vlerësimit të ndikimit në mjedis, për projektet në fushën e industrisë së energjisë.
- Nuk ka përmbushur kriterin 2.3.7 të Kritereve të Vecanta të Kualifikimit, pasi nuk ka deklaruar të dhënat e kërkuara për verifikimin e gjendjes gjyqësore.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë OE "Instituti Dekliada - ALB" sh.p.k. me NIPT K71606006A, me adresë: Njësia Bashkiake Nr. 5, Rruga "Milto Tutulani", ndertesa 4, hyrja 10, apartamenti 6, 1019, Tiranë, për vlerën 751,000 (shtatëqind e pesëdhjetë e një mijë) Lekë pa TVSH, se është identifikuar si ofertë e suksesshme.
Rrjedhimisht, jeni të lutur të paraqisni pranë Drejtorisë së Prokurimeve të OST sh.a., me *adresë Tiranë Kashar Yrshek, Autostrada Tiranë -Durrës, Km 9,* sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentet e tenderit, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit së këtij njoftimi.
Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të procedohet siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 03.12.2020.
Ankesa: Jo.

QENDRA SPITALORE UNIVERSITARE "NËNË TEREZA" TIRANË

Për: OE "Orthonet 360" shpk me Nr. NIPT L71614032H
Adresa:T IRANE Rruga Qemal Stafa, Zona Kadastrale nr.8370, Nr.Pasurise 9/557-M2

* * *

Procedura e prokurimit: "Procedurë e Hapur"-Marrëveshje Kuadër me nje operator ekonomikë ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara.
Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-73236-09-28-2020

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *"Blerje materiale mjekesore specifike per Sherbimin e Kirurgjise Oro-Maxillo-Faciale" per QSUT "NeneTereza" per 12 muaj*

Publikime të mëparshme *(nëse zbatohet):* Buletini i Njoftimeve Publike *[Data] [Numri]*

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: □ oferta ekonomikisht më e favorshme X çmimi më i ulët
Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatoren e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1."FEDOS"shpk me Nipt K01514009I
Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera : Me shumatore te cmimeve per njesi 830 540(teteqind e tridhjet mije e peseqind e dyzet) Lek pa TVSH dhe me vlerë të pritshme të

kontratave 19 862 300 (nentembedhjete milion e teteqind e gjashtedhjet e dy mije e treqind) Leke pa TVSH.

2. "MONTAL" shpk me NIPT J62009007F
Nuk ka paraqitur oferte ekonomike.

3."O.E.S DISTRIMED" shpk me NIPT K31520054N
Nuk ka paraqitur oferte ekonomike.

4."OrthoNet 360" shpk me NIPT L71614032H
Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera : Me shumatore te cmimeve per njesi 905 919,96 (nenteqind e pese mije e nenteqind e nentembedhjete pike nentedhejte e gjashte) Lek pa TVSH dhe me vlerë të pritshme të kontratave 24 606 978 (njezet e kater milion e gjashteqind e gjashte mije e nenteqind e shtatedhjete e tete) Leke pa TVSH.

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhtëm:

1. "MONTAL" shpk me NIPT J62009007F
2."O.E.S DISTRIMED" shpk me NIPT K31520054N
3."FEDOS"shpk me Nipt K01514009I

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

1. "MONTAL" shpk me NIPT J62009007F

Nuk ka paraqitur oferte ekonomike.

2. "O.E.S DISTRIMED" shpk me NIPT K31520054N

Nuk ka paraqitur oferte ekonomike.

3. "FEDOS"shpk me Nipt K01514009I

Mbi specifikimet teknike te paraqitura ne katalogun perkates te OE "Fedos" shpk, KVO paraqiti nje relacion te hollesishem ku pasqyrohen secili nga zerat qe plotesohen dhe nuk plotesohen duke i karahasuar me Specifikimet Teknike sipas shtojces 10 te DST. Konkretisht OE "Fedos" shpk referuar katalogut te paraqitur mr prodhues subjektin korean JEIL MEDICAL nuk ploteson kerkesat teknike si vijon:

Artikulli 1: Pllakë e drejtë maksile me 4 vrima dhe 4mm Bar
Nuk ploteson Specifikimin "4 mm bar" Pjesa ku referohet artikulli ne katalog nuk e permban fare si specifikim.

Artikulli 2: Pllakë e drejtë maksile me 5 vrima
Nuk ploteson specifikimin pasi pllaka e paraqitur eshte me 6 vrima

Artikulli 4: Pllakë në formë L, me 4 vrima, e shkurtër, me 3mm Bar, e majtë dhe e djathtë;Sistemi 1.6 Materiali të jetë titan.
Pjesa ku referohet artikulli ne katalog nuk e permban fare si specifikim.

Artikulli 5: Pllakë në formë L , me 4 vrima, e gjatë , me 6mm Bar , e majtë dhe e djathtë.

Nuk ploteson specifikimin "6 mm bar", ky specifikim nuk eshte katalog.

Artikulli 7: Vida hibride 1,6mm , me 10 përmasa , në diapazonin 4mm deri në 14mm.
Nuk ploteson specifikimet "vide hibride" dhe specifikimin "me 10 permasa".Artikulli i paraqitur nuk ehste vide hibride. Vidat hibride jane njekohesisht vete-shpuese dhe vete filetuese,ndersa vida e paraqitur eshte vide kortikale vetefiletuese.Gjithashtu ne katalog ky artikull ka vetem 7 permasa ne diapazon 4 mm-14 mm , nga 10 te kerkuara.

Artikulli 10: Freze Ǿ1.3 mm me gjatesi 4 mm, 5 mm, 8 mm, 15 mm
Nuk ploteson specifikimet pasi ne katalog nuk ka freze me gjatesi 15 mm.

Artikulli 11 – Pllake e drejte me 4 vrima , me 6 mm bar
Nuk ploteson specifikimet "6 mm bar" .Ky specifikim nuk eshte ne katalog

Artikulli 14: Pllake ne forme L , me 4 vrima , e shkurter , 3 mm bar , e majte e djathte , me kend 90 dhe 115 grade
Nuk ploteson specifikimin "3 mm bar" , katalogu nuk e permban .Nuk ploteson specifikimin me kend 90 grade dhe 115 grade pasi ka paraqitur pllake 90 me 110 grade.Nuk ka pllake me 115 grade.

Artikulli 15: Pllake ne forme L , me 4 vrima , e mesme , 5 mm bar ,e majte dhe e djathte me kend 90 dhe 115 grade.
Nuk ploteson specifikimin "5 mm bar" katalogu nuk permban .Nuk ploteson specifikimin me kend 90 grade dhe 115 grade pasi ka paraqitur pllake 90 dhe 110 grade .Nuk ka pllake me 115 grade.

Artikulli 16: Plake ne forme L , me 4 vrima, e gjate, 6 mm bar, e majte dhe e djathte me kend 90 dhe 115 grade .
Nuk ploteson specifikimet "6mm bar" ky specifikim nuk eshte ne katalog.

Artikulli 17: Pllake ne forme L dhe Z revers me 4 vrima
Nuk ploteson specifikimin pllake Z .Ka paraqitur vetem pllake L revers

Artikulli 18: Pllake ne forme Z , me 4 vrima e majte dhe e djathte me 5 mm bar.
Nuk ploteson specifikimet "5 mm bar" . Ky specifikim nuk eshte katalog . Edhe ne deklaraten e prodhuesit nuk ben fjale per pllake Z.

Artikulli 20: Pllake ne forme Y e madhe me 5 vrima.
Nuk ploteson specifikimin pasi pllaka e paraqitur eshte "e rregullt" dhe jo "e madhe"

Artikulli 21: Pllake ne forme T, me 6 vrima
Nuk ploteson specifikimin "ne forme T me 6 vrima"
Per kete artikull ka paraqitur 2 opsione : Opsioni 1 eshte pllake Y me 5 vrima , ndersa Opsioni 2 eshte pllake me 7 vrima. Asnje nga variantet nuk e ploteson specifikimin.

Artikulli 22: Pllake ne forme dopio T, me 6 vrima .
Nuk ploteson specifikimin "ne forme T me 6 vrima"

Per kete artikull ka paraqitur 2 opsione: Opsioni 1 eshte pllake Y me 6 vrima , ndersa ospisoni 2 eshte pllake I me 4 vrima . Asnje nga variantet nuk e ploteson specifikimin.

Artikulli 23: Vida hibride 2.0 mm , me 15 permasa, ne diapazonin 5 mm deri ne 19 mm.
Nuk ploteson specifikimin pasi artikulli i paraqitur nuk eshte vide hibride. Vidat hibride jane njekohesisht veteshpuese dhe vete filetuese , ndersa vida e paraqitur eshte thjesht vide kortikale vete filetuese. Gjithashtu ky artikull ka vetem 8 permasa ne diapazonin 5 mm -19 mm, nga 15 te kerkuara.

Artikulli 24: Vida auto-filetante 2.3 mm, me 4 permasa ne diapazonin 5 mm deri ne 8 mm.
Nuk ploteson specifikimet "me 4 permasa ne dapazonin 5 mm-8 mm", pasi ka vetem 2 permasa ne diapazonin 5mm -8 mm nga 4 te kerkuara.

Artikulli 27: Ǿ1.5 mm me gjatesi pune 5 mm
Nuk ploteson specifikimin " Freza Ǿ1.5 mm me gjatesi pune 5 mm" .Frezat e paraqitura jane me Ǿ1.6 mm asnjera nuk ka gjatesi pune 5 mm

Artikulli 29: Pllake e drejte rekonstruksioni me 4,6,8,16 vrima
Nuk ploteson specifikimin " me 4,6,8,16 vrima " Pllakat e paraqitura jane me 4,6,15, vrima . Mungojne pllaka me 8 dhe 16 vrima.

Artikulli 30 :Pllake rikonstruktive me 8 vrima , te ofrohet ne tre variante : me ure, e kendezuar dhe e harkuar.
Nuk ploteson specifikimet sistemi 2,4 dhe me "3 vrima" dhe "ne tre variantet me ure,e kendezuar dhe e harkuar". Artikulli BSSO eshte pllake e sistemit 2.0 (mini) dhe me 10 vrima nga 8 te kerkuara.Artikujt pllaka kendore dhe pllake e lakuar jane me 6 vrima nga 8 te kerkuara.

Artikulli 33:Vida locking kunder deforimimit
Nuk ploteson specifikimet "vide kunder deformimit" , pasi artikulli i paraqitur nuk eshte vide kunder deformimit , por vide e thjeshte locking

Artikulli 34 :Pllaka me shkallezim te shenuar per te ndihmuar modelimin
Nuk ploteson specifikimet "me shkallezim te shenuar" , pasi artkulli i paraqitur nuk eshte pllake me shkallezim te shenuar, por rrjet "mesh".

Artikull 35: Meshe e drejte e para modeluar
Nuk ploteson specifdikimet pasi artikulli i paraqitur nuk eshte meshe "e modelueshme" dhe jo "e pamodeluar" sic eshte kerkuar.

Ne shtojcen 10 te Dokumenteve Standart te Tenderit DST eshte kerkuar:
Per te gjithe artikujt e ofruar te paraqiten kataloge, <u>ku te perfshihen edhe specifikimet teknike te hollesishme per secilin artikull (</u>pjeset e katalogut qe permbajne emertimin dhe specifikimet e detajuara teknike te artikullit qe ofertohet, nese nuk jane ne gjuhen shqipe , te perkthehen ne gjuhen shqipe dhe te noterizohen).Operatori ekonomik duhet te markoje ne katalogun perkates produktet qe ofron sipas numrit rendor (te markuara sipas artikullit) te percaktuar ne formularin e ofertes. Kataloget do te pranohen vetem ne forme elektronike nepermjet sistemit elektronik te prokurimit.

Te respektohen specifikimet teknike te kerkuara nga sherbimi per cdo artikull.
Mbeshtetur ne nenin 53 te ligjit 9643 date 20.11.2006 "Per Prokurimin Publik" i ndyshuar, ku percaktohet se:

Neni 53
Autoriteti Kontraktor nuk e pranon nje oferte :

a)Kur ofertuesi nuk eshte i kualifikuar
b)kur ofertuesi nuk pranon korrigjimin e nje gabimi aritmetik , i bere sipas pikes 2 te ketij neni.
c)Kur oferta e tij nuk perputhet me spwecifikimet teknike e percaktuara ne dokumentat e tenderit , me perjashtim te rasteve te parashikuara ne nenin 54 te ketij ligji

Komisioni i Vleresimit te Ofertave vendos te refuzoje oferten e Operatorit Ekonomik "FEDOS" shpk per arsye se ajo nuk permbush specifikimet teknike sipas shtojces 10 te DST, per 23 zera nga 35 te kerkuar nga sherbimi

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se jane identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

"OrthoNet 360" shpk me NIPT L71614032H me shumatore te cmimeve per njesi 905 919,96 (nenteqind e pese mije e nenteqind e nentembedhjete pike nentedhejte e gjashte) Lek pa TVSH dhe me vlerë të pritshme të kontratave 24 606 978 (njezet e kater milion e gjashteqind e gjashte mije e nenteqind e shtatedhjete e tete) Leke pa TVSH dhe 25 415 378 (njezet e pese milion e katerqind e pesembedhjete mije e treqind e shtatedhjete e tete) leke me TVSH.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza" Tiranë me adresë: Rruga e Dibrës, Nr. 372 - Tirane brenda 5 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për nënshkrimin e marrëveshjes kuadër.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë : 05.11.2020

Ankesa: PO

Eshte paraqitur ankese lidhur me vendimin e marre nga ana e KVO-se, ne date 12.11.2020 , nga operatori ekonomik "Fedos" shpk. .

Procedura u pezullua me Vendim Pezullimi Nr 2959/3 prot date 13.11.2020 per shkak te shqyrtimit te ankeses me Nr 3416 prot date 12.11.2020.
Per shqyrtimin e ankeses u ngrit Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave, i cili me vendimin 3416/2 prot date 20.11.2020 vendosi te mos pranoje pretendimet e OE duke mbajtur ne fuqi vendimin e KVO-se. Me date 23.11.2020 me shkresen nr 3416/3 prot i eshte kthyer pergjigje operatorit ekonomik lidhur me vendimin qe ka marre Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave.
Pasi eshte ezauruar afati 10-ditor i parashikuar ne Nenin 63, pika 6 te Ligjit 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar dhe ankimuesi nuk ka paraqitur nje ankese me shkrim ne Komisionin e Prokurimit Publik kunder vendimit te AK (KSHA) brenda 10 diteve nga e nesermja e dites se punes qe eshte njoftuar per vendimin e KSHA-se, AK nuk ka marre njoftim per ankese ne

KPP sipas parashikimeve te LPP, si dhe pas verifikimeve te bera nga ana e AK ne faqen zyrtare te KPP nuk rezulton te jete paraqitur ankese per kete objekt prokurimi.
Me shkresen Nr 2959/5 prot date 07.12.2020 ka dale vendim per heqjen e pezullimit.

BASHKIA VLORË

Për: ["MURATI D", adresa: Rruga Kavajës, Ish- Kombinati Ushqimor, Godinë 1- katëshe, Tiranë]

***

Procedura e prokurimit: Kërkesë për Propozim

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-78212-11-10-2020

Përshkrim i shkurtër i kontratës: "Blerje detergjentë për nevoja të Bashkisë Vlorë"

Publikime të mëparshme *(nëse zbatohet):* Buletini i Njoftimeve Publike [----------] [-------]
Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X oferta ekonomikisht më e favorshme □

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Shoqëria "MURATI D" K42003004T
2. Data e zhvillimit të ankandit: Datë 12/01/2021 ora 11.00

3. Lloji i Procedurës standarte të ankandit: Ankand i hapur.

4. Objekti shitjes: "Shitje e materialit drusor të vlerësuar në ngastrat e dëmtuara nga faktorë të ndryshëm natyrorë dhe nga zjarret".

5. Përshkrim i shkurtër i objektit të shitjes: Bashkia Gramsh do të shesë në ankand materialin drusor të të vlerësuar në ngastrat e dëmtuara nga faktorë të ndryshëm natyrorë dhe nga zjarret(e llojit dru zjarri sasia 2734 m^3) në Ekonominë pyjore Holtë-Lukovë, nëngastra 57/a dhe nëngastra 57/b.
6. Vlera fillestare e ankandit : 820 200(tetëqind e njëzetëmijë e dyqind)lekë.

7. Vendi i zhvillimit të ankandit(Adresa) :Bashkia Gramsh, salla e mbledhjeve, kati i dytë i godinës .

8. Afati fundit kohor për dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje: Datë 12/01/2021 ora 11.00,
9. Informacion mbi dokumentat e ankandit:

Dokumentat e ankandit mund të tërhiqen pranë Autoritetit Shitës , ,kundrejt kërkesës me shkrim (të firmosur e vulosur) dhe kundrejt pagesës përkatëse.
Dokumente me pagese:

Po X Jo ☐

Nëse po

Monedha Lekë Cmimi 1000(njëmijë)

Dokumentet standarte të ankandit përbëhen nga:

- Formulari njoftimit,
- Kërkesë për pjesëmarrje,
- Formulari i ofertës,
- Ftesa për ofertë,
- Formulari njoftimit të fituesit,

- Formulari i publikimit të njoftimit të fituesit,
- Procesverbali/et i/e e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

10. Kërkesa për pjesëmarrje,dokumentet dhe informacionet e kërkuara dorëzohen nga kandidatët blerës në kopje fizike,me postë ose dorazi,në vendin e përcaktuar në dokumentat e ankandit.

BASHKIA LIBRAZHD
NJOFTIM ANKANDI

1. Autoriteti shites: BASHKIA LIBRAZHD.
(adresa, nr. tel): Qyteti Librazhd Nr.Tel & fax. 0514 / 2352, e-mail; librazhdbashkia@yahoo.com

2. Data e zhvillimit te ankandit : 12/01/2021 ora 10.00.

3. Lloji i Procedurës standarde te ankandit : Procedure e Hapur

4. Objekti i Shitjes: "Për shitjen e lëndës drusore sipas asortimenteve"

5. Përshkrim i shkurtër i objektit të shitjes: Bashkia Librazhd kërkon të shesë me ankand sasitë e lëndës drusore, që ndodhen në pikat e grumbullimit të bashkisë, të prodhuara nga ana e saj për trupa dhe lëndë ndërtimi si dhe dru zjarri të rezultuara tepër pas plotësimit të nevojave për shkollat dhe entet publike të saj.

Sasitë dhe vlerat fillestare sipas loteve janë sipas tabelës së mëposhtme:

Lotet	Vëndi pikës depozitimit	Asortimenti	Lloji drusor	Njësia matjes	Sasia	Çmimi për njësi	Vlefta lekë që prezantohet në ankand
Loti I-rë	Hotolisht	Trupa	Ah	m^3	80	7300	584 000
		Lëndë ndërtimi	Ah	m^3	25.8	6100	157 380
		Dru zjarri	Ah	mst	602	2800	1 685 600
		Totali Loti Parë					2 426 980
Loti II-të	Polis	Trupa	Ah	m^3	162.2	7300	1 184 060
		Lëndë ndërtimi	Ah	m^3	16	6100	97 600
		Dru zjarri	Ah	mst	231	2800	646 800
		Totali Loti Dytë					1 928 460
Loti III-të	Zdrajsh Katund	Trupa	Ah	m^3	108	7300	788 400
		Dru zjarri	Ah	mst	70	2800	196 000
		Totali Loti Tretë					984 460

6. Vendi i zhvillimit te ankandit: (Adresa:) Salla e Këshillit te Bashkise Librazhd (Kati i dyë)

7. Afati i fundit kohor për dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje: datë 12.01.2021, ora 10.00

8. Informacion mbi dokumentet e ankandit:
Dokumentet e ankandit mund te terhiqen prane autoritetit shites
Dokumente me pagesë:
Po X Jo □

Nëse Po

Monedha Leke Çmimi 1000

Dokumentet standarde te ankandit përbehen nga:

- Formulari i njoftimit;
- Kërkesa për pjesëmarrje;
- Formulari i ofertës;
- Ftesa për oferte;
- Formulari i njoftimit te fituesit;
- Formulari i publikimit te njoftimit te fituesit;
- Procesverbali/et i/e Komisionit te Vlerësimit te Ofertave.

10. Kërkesa për pjesëmarrje, dokumentet dhe informacionet e kërkuara dorëzohen nga kandidatet blerës ne kopje fizike, me poste ose dorazi, ne vendin e përcaktuar ne dokumentet e ankandit.

NJOFTIME FITUESI ANKANDI

BASHKIA PEQIN

NJOFTIM FITUES ANKANDI

Për: Panorama Energy SRL shoqeri e huaj me nr.J16/543/2013 nipti dhe kodi fiskal 31420713 me adrese Craiova ,Calea Bucuresti nr.285,blloku C3 apartamenti 7 ,Rumani .

* * *

Procedura e ankandit: "Shitjen e 75% te aksineve te shoqerise aksionere Futboll Klub Shkumbini , Procedure e Hapur "

Përshkrim i shkurtër i procedures se ankandit dhe objketit te tij: Shitjen e 75% te aksioneve te shoqerise aksionere Futboll Klub Shkumbini ,Ne pronesi te Bashkise Peqin.

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike nr.99 date 09.11.2020
Njoftojme se, kane qene pjesemarres ne procedure keta ofertues me vlerat perkatese te ofruara:

1.Panorama Energy SRL	J16/543/2013
Emri i plotë i shoqërisë	numri i NIPT-it

Vlera 750 000 (shtateqind e pesedhjete mije) leke.

Etj._____

Jane skualifikuar ofertuesit e meposhtem: Nuk ka patur te skualifikuar

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik Panorama Energy SRL shoqeri e huaj me nr.J16/543/2013 nipti dhe kodi fiskal 31420713 me adrese Craiova ,Calea Bucuresti nr.285,blloku C3 apartamenti 7 ,Rumani me administrator z.Alessandro Borrella se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 750 000 (shtateqind e pesedhjete mije] është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkise Peqin me adrese Bulevardi Mustafa Gjinishi ,Kati i dyte ,Zyra Juridike kopjen e nënshkruar të formularit të kontratës dhe të sigurimit të kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 58 të ligjit për prokurimet publike nr.9643 date 20.11.2006

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë : 02/12/2020

Ankesa: ka ose jo : Nuk ka patur
(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË

Për: [Hilmi Myrtollari, L. 17, Rr: Ajet Gjindolli, Korçë]

* * *

Procedura e ankandit: [“Shitje e 285 dengjeve me jonxhë”, procedurë e hapur]
Përshkrim i shkurtër i procedures se ankandit dhe objektit te tij: [Shitje e 285 dengjeve me jonxhë, prodhim i Ekonomisë Didaktike Eksperimentale, njësi e Universitetit “Fan S. Noli”, Korçë]
Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]
Njoftojme se, kane qene pjesemarres ne procedure keta ofertues me vlerat perkatese te ofruara:
1. Hilmi Myrtollari (individ) 034001537
Emri i plotë i shoqërisë numri i letërnjoftimit
Vlera: 71 250 (shtatëdhjetenjëmijedyqindepesëdhjetë) lekë
(me numra dhe fjale)
Jane skualifikuar ofertuesit e meposhtem: Nuk u skualifikua asnjë ofertues.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [Hilmi Myrtollari, L. 17, Rr: Ajet Gjindolli, Korçë] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [71 250 (shtatëdhjetenjëmijedyqindepesëdhjetë)] është identifikuar si oferta e suksesshme.
Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [Znj. Enslemvera Zake, Administratore e Universitetit “Fan S. Noli”, Bulevardi “Rilindasit”, Korçë] kopjen e nënshkruar të formularit të kontratës dhe të sigurimit të kontratës, siç parashikohet në dokumentat e ankandit, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të veprohet siç parashikohet në nenin 39, të ligjit nr. 9874, datë 14.02.2008, “Për Ankandin Publik”, i ndryshuar.
Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë: 02.12.2020
Ankesa: nuk ka.

KONTRATA TË LIDHURA ANKANDI

UNIVERSITETI “FAN S. NOLI” KORÇË

1.Autoriteti shitës: Adresa: Bulevardi ”Rilindasit”, Korçë	Universiteti Fan S. Noli, Korçë Tel:003558242230
2.Lloji i procedurës së ankandit:	Procedurë e hapur
3.Objekti i ankandit:	“Shitje gruri”
4.Vlera fillestare e shitjes:	66 000 lekë pa TVSH
5.Vlera totale e kontratës:	66 000 lekë pa TVSH (22 lekë/kg)
6.Data e lidhjes së kontratës:	07.12.2020
7.Ofertuesi fitues:	Ilirian Skënderas, Turan, Korçë Numri i pasaportës: BE1317519

ANULLIME ANKANDI

KËSHILLI I QARKUT GJIROKASTËR

NJOFTIM ANULLIMI ANKANDI

Autoriteti shitës, Këshilli i Qarkut Gjirokastër, njofton se në mbështetje të Nenit 13 të Ligjit 9874 datë.14.02.2016 "Për ankandin publik", ankandi Procedurë e hapur, me objekt "Autoveturë "Mercedes Benz", Modeli E320 CDI AVANTGARDE 4DR në pronësi të Keshillit te Qarkut Gjirokaster", zhvilluar me date 16.11.2020, ora 11:00, është anulluar për shkak të mungesës së konkurencës (nuk është paraqitur asnjë ofertë).

TË TJERA ANKANDE

KREU I KATËRT

Buletini i ofertave të qirave

BASHKIA PËRMET

Emri dhe adresa e autoritetit qiradhënës

Emri: Bashkia Përmet
Adresa: Sheshi "Abdyl Frashëri", Përmet
Tel/Fax: +355 813 222 54
E-mail: info@bashkiapermet.gov.al

Bashkia Përmet në cilësinë e autoritetit qiradhënës, në zbatim të shkronjës "c" të pikës 1.2 të nenit 9 "Të drejtat dhe përgjegjësitë", shkronjës "e" të nenit 54 të ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar, neni 2 i ligjit nr. 8312, datë 26.03.1998 "Për tokat bujqësore të pandara", neni 3 I ligjit nr. 8744, datë 22.02.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 531, datë 21.08.1998 "Për tokat bujqesore të pandara" I ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 510, datë 10.6.2015 " Pë rmiratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial", Udhëzimin nr. 1, datë 18.07.2012, të Këshillit të Ministrave, "Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara", si dhe:

- Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 46 datë 11.08.2020 "Për miratimin e nisjes së procedurave për dhënien me qira të tokave bujqësore të pandara të ish-kooperativave bujqësore", zhvillon procedurë konkurruese për dhënien me qira të sipërfaqes së tokës bujqësore prej **1.38 Ha**, të ndodhur në Njësinë Administrative Petran si më poshtë:

- Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 46 datë 11.08.2020 "Për miratimin e nisjes së procedurave për dhënien me qira të tokave bujqësore të pandara të ish-kooperativave bujqësore", zhvillon procedurë konkurruese për dhënien me qira të sipërfaqes së tokës bujqësore prej **1.38 Ha**, të ndodhur në Njësinë Administrative Petran si më poshtë:

Nr	Nj. A	Fshati	Zona Kadastrale	Nr. Parcelës / pasurisë	Sipërfaqja /Ha
1	Petran	Badlonjë	1071	82´	0.44 ha
2	Petran	Badlonjë	1071	84/6	0.097 ha
3	Petran	Badlonjë	1071	87/5	0.806 ha
4	Petran	Badlonjë	1071	84/8	0.034 ha

- Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 47 datë 11.08.2020 "Për miratimin e nisjes së procedurave për dhënien me qira të tokave bujqësore të pandara të ish-kooperativave bujqësore", zhvillon procedure konkurruese për dhënien me qira të sipërfaqes së tokës bujqësore prej **3.675 Ha**, të ndodhur në Njësinë Administrative Petran si më poshtë:

Nr	Nj. A	Fshati	Zona Kadastrale	Nr. Parcelës/pasurisë	Sipërfaqja/Ha
1	Petran	Lipivan, Melan	3632	Nr. A	1.018 ha
2	Petran	Lipivan, Melan	3632	Nr. A-1	0.618 ha
3	Petran	Lipivan, Melan	3632	Nr. B	0.645 ha
4	Petran	Lipivan, Melan	3632	Nr. C	0.88 ha
5	Petran	Lipivan, Melan	3632	Nr. C-1	0.14 ha
6	Petran	Lipivan, Melan	3632	Nr. Ç	0.978 ha

I.Subjektet e interesuara, së bashku me ofertën për qiramarrje pranë autoritetit qiradhënës, duhet të paraqesin dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Identitetin e të interesuarit, si dhe në rastin e personave fizikë ose juridikë, dokumentin e regjistrimit si subject tregtar;
2. Afatin e qerasë i cili duhet të jetë në përputhje me Kreun IV të Udhëzimit nr. 1, datë 18.07.2012, të Këshillit të Ministrave, "Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara",
3. Veprimtaria bujqësore që do të zhvillohet mbi tokën e marrë me qira duke përcaktuar kulturat bujqësore ose specia te bimëve që do të mbillen, me të cilat lidhet kjo veprimtari.
4. Aspektet kryesore të teknologjisë që do të aplikohet në kultivimin e bimëve dhe përpunimin e produkteve.
5. Investimet kryesore mbi infrastrukturën (kullim, ujitje, sistemime etj), të shprehura në tregues fizikë dhe monetarësi dhe investimet e lidhura me mbjelljen e kultivimin e bimëve si dhe përpunimin e produkteve.
6. Burimet e financimit që garantojnë investimet të shprehura në vlerën monetare.
7. Ndikimin e investimit në rritjen e numrit të të punësuarve në Bashki.
8. Propozimin për çmimin e ofruar për marrjen e tokës bujqësore me qira (lekë/ha në vit)
9. Vërtetimin se nuk ka detyrime financiare ose ligjore të pashlyera ndaj Bashkisë Përmet.

Ofertat paraqiten në një zarf të mbyllur, I cili duhet të përmbajë një kopje origjinale dhe një të fotokopjuar të dokumentacionit të ofertës.

II. Subjektet e interesuara mund të kërkojnë informacion për procedure konkurruese, pranë Bashkisë Përmet,

- Ofertuesit të paraqesin vetëm një ofertë, ku të angazhohen se pranojnë kushtet e përcaktuara në shpallje për procedure konkurruese dhe detyrimet që rrjedhin nga fitimi I procedures konkurruese. Shpenzimet e kryera për të marrë pjesë në procedure konkuruese nuk rimbursohen nga Autoriteti Qiradhënës.
- Çmimi fillestar i dhënies së tokës bujqësore me qira si në rastin e paraqitjes së një kërkese ashtu edhe në rastin e paraqitjes së dy apo më shumë kërkesave për të njëjtën siperfaqe është 6000 (gjashtemijë) lekë/ha në vit. Ofertat me vlerë më të ulët se kjo vlerë fillestare do të skualifikohen.
- Asnjë ofertues nuk do të përjashtohet nga pjesëmarrja në procedurën e konkurrimit në bazë të shtetësisë.

Afati i fundit për dorëzimin e ofertave është **dita e mërkurë me datë 06/01/2021, ora 13:00.**
Ofertat e dorëzuara pas këtij afati do të refuzohen.

Ofertat do të hapen në Bashkinë PËRMET, S a l l a e Kë s h i l l i t , K a t i II, date 14/01/2021, **ora 10:00.**
Përfaqësues të ofertuesve janë të ftuar të ndjekin procedurën e hapjes së ofertave.

KONCESIONE / PARTNERITET PUBLIK PRIVAT

PROCEDURA KONKURRUESE PËR LEJE MINERARE

NJOFTIME TË TJERA

MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

NJOFTIM PËR DHËNIE KONTRATE

Shërbime Konsulence

Ref. no. WRIP/2/CS/002

Emri i Projektit: **Shqipëria – Projekti i Burimeve Ujore dhe Ujitjes në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural**	ID e Projektit te Bankës Botërore: **P121186**
Emërtimi i Kontratës: **Vlerësimi dhe Hartëzimi i Infrastrukturës së Ujitjes dhe Kullimit në bashkitë me bujqësisë intensive në Shqipëri**	Objektivat Kryesore: **Objektivat e këtij projekti janë:** **o Hartimi dhe vlerësomi infrastrukturës I&D në bashkitë e vendit përmes një kombinimi të metodave duke përfshirë interpretimin/dixhitalizimin orthophoto dhe kontrollin në terren në nivel bashkie;** **o krijimi i një sistemi të centralizuar GIS me informacion hapësinor të skemave I&D që do të aksesohet dhe përdoret si nga bashkite ashtu edhe nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;** **o krijimi procedurave, udhëzimeve dhe mjeteve të nevojshme për mirëmbajtjen dhe azhornimin e sistemit;** **o trainimi i përdoruesve për përdorimin e sistemit si në nivelin bashkiak ashtu edhe në nivel ministrie.**
Metoda e Përzgjedhjes: **Përzgjedhja e bazuar në kosto dhe cilësi (QCBS)**	Kohezgjatja: **6 muaj**

Konsulenti Fitues

Emri dhe adresa e konsulentit fitues	Propozimi Financiar lexuar ne hapjen publike Pa TVSH 20% (ne Lek)	Propozimi Financiar përfundimtar Pa TVSH 20% (në Lek)
IDRA sh.p.k.		

Rr. Siri Kodra, Pall. 94/5, Ap 49, Tirane, Shqiperi	**61,514,539.00**	**61,514,539.00**

Vlerësimi Teknik e Financiar

No.	Konsulenti / Bashkimi Konsulenteve (J-V)	Kombësia	Piket (P)	Vleresimi Teknik (T) (P) x 80%	Propozimi Financiar	Kursi këmbimit	Propozimi Financiar (në Lek)	Vlersimi Financiar (Sf x P%)	Vleresimi i Kombinuar	Renditja
1	Abkons sh.p.k.	Shqipëri	76.69	61.35	ALL 43,238,915.36	1.00	ALL 43,238,915.36	20.00	81.35	3
2	J-V CACG & Geo Consulting Albania	France / Shqiperi	78.58	62.86	$ 592,344.00	105.99	ALL 62,782,540.56	13.77	76.63	4
3	J-V Compet-Terra Ltd & FCG Swedish Development AB	Hungari / Suedi	90.41	72.33	€ 555,154.00	124.05	ALL 68,866,853.70	12.56	84.89	2
4	J-V Consorzio per il Sistema Informativo (CSI PIEMONTE) & Agriconsulting Europe Sa & Datech sh.p.k.	Itali / Belgjike / Shqiperi	79.42	63.54	ALL 102,009,541.30	1.00	ALL 102,009,541.30	8.48	72.02	5
5	IDRA sh.p.k.	Shqiperi	90.17	72.14	ALL 61,514,539.00	1.00	ALL 61,514,539.00	14.06	86.20	1

MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

Njoftim për Dhënie Kontrate

Mallra

Ref. no. WRIP/2/G/001

Emri i Projektit: **Shqipëria – Projekti i Burimeve Ujore dhe Ujitjes në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural**	ID e Projektit te Bankës Botërore: **P121186**
Emërtimi i Kontratës: **Blerje e Tableteve (TE)**	Objekti i Kontratës: **Blerje e Tableteve (pajisje informatike) per Mjeshtrat e Ujit në disa bashki të vendit**
Metoda e Përzgjedhjes: **Blerje (Shopping)**	Kohëzgjatja: **2 muaj**

Ofertuesi Fitues i Kontratës

Emri dhe adresa e Fituesit	Oferta financiare në hapjen e ofertave Pa TVSH 20% në Lek	Oferta e Vleresuar Pa TVSH 20% në Lek
Eagle Security System sh.p.k. Rr. "Shyqyri Brari", Pall. 3, Kullat Brair, shk 1, kati I, Tirana	**1,642,600**	**1,642,600**

Ofertuesit e Vlerësuar

Emri Ofertuesit te Vleresuar	Oferta financiare në hapjen e ofertave Pa TVSH 20% në Lek	Oferta e Vleresuar Pa TVSH 20% në Lek
Alfa Services sh.p.k.	**1,720,000**	**1,720,000**
Tetra Solutions sh.p.k.	**1,763,000**	**1,763,000**
Communication Progress sh.p.k.	**1,935,000**	**1,935,000**

Ofertues te refuzuar		
Emri Ofertuesit te Refuzuar	Oferta financiare në hapjen e ofertave Pa TVSH 20% në Lek	Arsyet e Refuzimit
Nuk ka		

BANKA E SHQIPËRISË
TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: "Shërbimi vjetor i mirëmbajtjes dhe riparimit të disa pajisjeve UPS të sallave operatore të Bankës së Shqipërisë".
'Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me fond limit 2,165,500 Lekë".
Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411(ext. 214), çdo ditë nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkese me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e pakthyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:
Përfituesi: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC
Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "Shërbimi vjetor i mirëmbajtjes dhe riparimit të disa pajisjeve UPS të sallave operatore të Bankës së Shqipërisë"
Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë 05 Janar 2021, ora 11:00, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

BANKA E SHQIPËRISË
TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: "Blerje e programit dhe 3 licencave të tij, për regjistrimin e inventarit dixhital të koleksionit të Muzeut të Bankës së Shqipërisë".
'Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me fond limit 870,300 Lekë".
Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411(ext. 214), çdo ditë nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkese me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e pakthyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:
Përfituesi: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR

IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC
Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "Blerje e programit dhe 3 licencave të tij, për regjistrimin e inventarit dixhital të koleksionit të Muzeut të Bankës së Shqipërisë"
Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë 05 Janar 2021, ora 13:00, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

UNIVERSITETI I SPORTEVE

Njoftim per vend te lire pune

Njoftimi për rishpalljen e konkursit për 2 (dy) vende pune për personel akademik "Lektor" dhe "Asistent/Lektor", pranë Departamentit të Disiplinave Mjekësore dhe Humane, Fakulteti i Shkencave të Rehabilitimit, në Universitetin e Sporteve të Tiranës.

I. Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme për pozicionin e punës "Lektor" me kohë të plotë për lëndën: "Patologji në sport", në modulet; "Fiziologji patologjike në sport", Patologjitë dhe sporti, Sëmundjet e brëndshme në sport"

Nr	KRITERET	PIKË
1	Të jetë diplomuar në Fakultetin e Mjekësisë në Degën e Mjekësisë së Përgjithshme me mesatare të ponderuar mbi notën 8 (tetë)	Deri i në 10 pikë
2	Të ketë së paku gradën shkencore "Doktor. Titujt shkencorë janë të preferuar	Deri në 15 pikë
3	Të kenë kryer programin e studimeve të specializimit afat-gjatë në mjekësi. Specializimi në fushat e përafërta është i preferuar	5 pikë
4	Të ketë eksperiencë në mësimdhënie në IAL	Deri në 10 pikë
5	Të ketë kryer kualifikimi kombëtare dhe ndërkombëtare akademike në fushën e kërkuar	Deri në 10 pikë
6	Të ketë kryer aktivitete shkencore si: referime dhe botime brënda dhe jashtë vendit	Deri në 10 pikë
7	Vlerësohen kualifikime të ndryshme në nivel pasuniversitar që i përkasin fushës	Deri në 8 pikë
8	Të ketë 2 (dy) referenca nga profesorë të fushës	Deri në 2 pikë
9	Intervista	30 pikë

II. Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme për pozicionin e punës "As/Lektor" me kohë të plotë për lëndën: "Rehabilitim i Përgjithshëm", Modulet; Rehabilitim i Aparatit Lokomotor, Rehabilitim në Geriartri, Rehabilitim Logopedik.

Nr.	KRITERET	PIKË
1	Të ketë mbaruar studimet e larta universitare për fizioterapi me noten mesatare mbi 8 (tetë)	Deri i në 10 pikë
2	Të ketë notë mesatare mbi 8-të në studimet e nivelit Bachelor, DIND dhe	Deri në 10

	Master Shkencor	pikë
3	Të zotërojë gjuhën angleze me dëshmi të Universitetit të Tiranës, ose nga një Agjensi me Njohje Ndërkombëtare	Deri i në 5 pikë
4	Të ketë eksperiencë në mësimdhënie në IAL	Deri në 10 pikë
5	Kanë preferencë kandidatët që kanë kryer kualifikime kombëtare dhe/ ose ndërkombëtare që lidhen me fushën	5 pikë 10 pikë
6	Të ketë kryer aktivitete shkencore si: referime, botime brënda dhe jashtë vendit.	Deri në 15 pikë
7	Vlerësohen kualifikime te ndryshme në nivel pasuniversitar që i përkasin fushës së lëndës.	Deri në 8 pikë
8	Të ketë 2(dy) referenca nga profesorë të fushës.	Deri në 2 pikë
9	Intervista	30 pikë

Shënim:

- Intervista e kandidatit nga Komisioni i Vlerësimit do të bëhet në gjuhën Shqipe dhe Angleze.
- Intervista fokusohet:
  - Niveli i motivimit të kandidatit dhe njohuritë e fushës.
  - Njohuritë profesionale që kanë për lëndën në të cilën kandidon.
  - Vizioni mbi zhvillimin e fushës për të cilin kandidon.
- Për të tre kategoritë e pyetjeve të intervistës, pyetjet do të alternohen në gjuhën shqipe dhe atë Angleze.
- Vlerësimi i Kandidatit në Total është me 100 pikë, 30 pikë nga Intervista dhe 70 pikë nga kriteret e përcaktuara.
- Kriteret nga 1 deri në 4 janë kritere bazë dhe kandidati që nuk plotëson qoftë dhe njëren prej tyre skualifikohet. Kriteret nga 5 deri në 9 janë preferenciale.
- Kandidati që shpallet fitues duhet të fitojë 50 pikë e lart.

III. Të interesuarit duhet të dërgojnë më anë të shërbimit postar në Protokollin e Universitetit të Sporteve të Tiranës këto dokumenta:

a. Kërkesë për vendin e punës si dhe vizioni për fushën.
b. CV
c. Diplomë e shkollës së lartë dhe certifikatë notash e noterizuar.
d. Diploma e certifikata të ndryshme të kualifikimeve të noterizuara.
e. Dëshmi e zotërimit të gjuhës së huaj e noterizuar.
f. Dëshmi penaliteti ose formular vetëdeklarimi
g. Refereca nga profesorë të fushës.
h. Fotokopje të pjesëmarrjeve në konferenca, të artikujve shkencorë të publikuar në revista ndërkombëtare profesionale/shkencore dhe/ose punime të tjera;
i. Certifikatë e gjendjes familjare.
j. Raport mjeko ligjor .

IV. Konkursi fillon nga dita e shpalljes në Buletinin e Njoftimeve Publike dhe përfundon dy javë pune pas këtij njoftimi.

V. Vetem paketat e aplikimit të mbërritura me anë të shërbimit postar pranohen dhe data në vulën e Postës Shqiptare do të shërbejë për të përcaktuar respektueshmërinë e afatit të aplikimit të kandidatëve.

VI. Në zarf duhet të shënohet adresa e sakte e aplikimit; Universiteti i Sporteve të Tiranës, Fakulteti, Departamenti, specialiteti ku aplikon, emri, mbiemri, Nr. telefonit dhe e-mail të konkurentit.

VII. Mosparaqitja e saktë dhe e qartë e këtyre të dhënave përbën shkak për mospranimin e paketës së konkurentit.

FAKULTETI I EKONOMISË

Njoftim per vend te lire pune

Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës, rishpall konkursin për personel Ndihmësakademik me karakter Administrativ me kohë të plotë pranë njësisë kryesore për 3(tre) vendet e lira të punës në pozicionin "Specialist mësimor në degën mësimore", si më poshtë:
Kandidatët që konkurojnë për Specialist mësimor në degën mësimore duhet të plotësojnë këto kritere të përgjithshme:

1. Të jetë diplomuar në ciklin e dytë të studimeve në Master i Shkencave, DIND ose në Master Profesional në Universitetet publike brënda vendit.
2. Të zotërojë gjuhën Angleze me dëshmi.
3. Të jetë shtetas shqiptar me zotësi të plotë për të vepruar.
4. Të zotërojnë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin e punës për të cilin konkurojnë.
5. Të mos jenë dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata për kryerjen e një vepre penale me dashje.
6. Të mos jetë marrë masë disiplinore e largimit nga puna.

Kriteret preferenciale:

1. Të ketë njohuri të Ligjit të Arsimit të Lartë.
2. Të njohë programet bazë kompjuterike.
3. Të ketë aftësi shumë të mira komunikimi dhe të dijë të punojë në grup.

Kandidatët që do të aplikojnë për këto vende pune duhet të dorëzojnë pranë Zyrës së Burimeve Njerëzore në Fakultetin e Ekonomisë të Universitetit të Tiranës, këto dokumenta:

1. Kërkesë me shkrim për pozicionin e punës për të cilin aplikon.
2. Jetëshkrim i plotësuar në gjuhën shqipe (CV – Curriculum Vitae).
3. Diplomë dhe listë notash për të gjitha ciklet e studimeve universitare (të noteruar). Për diplomat e marra në universitetet e huaja, duhet të dorëzohet fotokopje e noteruar e çertifikatës së njohjes nga strukturat përgjegjëse përkatëse.
4. Dëshmi të njohjes dhe përdorimit të çdo çertifikate apo dëshmie kualifikimi që kanë (të noteruar).
5. Dëshmi e zotërimit të gjuhës së huaj (të noteruar).
6. Të paktën një referencë nga punëdhënësi i fundit.

7. Kopje të librezës së punës dhe të kontributeve të sigurimeve shoqërore.
8. Vertetim të gjendjes shëndetësore.
9. Dokument identifikimi.
10. Dëshmi penaliteti.

Përzgjedhja e kandidatëve fitues do të bëhet nëpërmjet konkurimit me dosje dhe me intervista të drejtpërdrejta.
Afati i dorëzimit të dokumentacionit është nga data 21.12.2020 – 11.01.2021.

UNIVERSITETI I MJEKËSISË

Njoftim per vend te lire pune

Bazuar në ligjin nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", në vendimin e Bordit të Administrimit Nr.11, datë 03.02.2020 "Për miratimin e kritereve të punësimit të personelit administrativ të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë", si dhe në mbështetje të shkresës nr.495/2 prot, datë 14.12.2020 "Dërgohen kriteret për personel administrativ "Kryetar i Degës së Financës " në Fakultetin e Mjekësisë Dentare" dhe 2232/3 dt.14.12.2020 si dhe Urdhri nr. 192 date. 16.12.2020 , Administratori i UMT, shpall konkurimin per një vende vakant pune, si me poshte:

- Per një vende vakant për personel administrativ ne pozicionin " Kryetar i Degës së Finaces", pranë Fakultetit të Mjekësisë Dentare, Universiteti i Mjekesise Tirane,

Përshkrimi përgjithësues i punës:

- Kryetari i degës është përgjegjësi kryesor për mbarëvajtjen e punës në degën e financës. Koordinon punën vertikalisht me strukturat që ka në varësi: specialist dhe raporton rregullisht te Administratori i njësisë kryesore.
- Kryen rolin e nëpunësit zbatues.
- Ndjek gjithë veprimet financiare që lidhen me shpenzimet për veprimtarine e njësisë dhe bën mbylljen e bilancit vjetor
- Merr pjesë në hartimin e buxhetit vjetor, në bashkëpunim me strukturat e tjera të njësisë.
- Merr pjesë në përgatitjen e programit buxhetor afatmesem në zbatim të kërkesave të ligjit dhe institucioneve përkatëse.
- Ndjek gjithë veprimet financiare që lidhen me të ardhurat e njësisë dhe raporton për realizimin e tyre.
- Ndjek shpenzimet e buxhetit dhe të fondeve të tjera që disponon njësia, rakordon çdo muaj situacionin e shpenzimeve ekonomike, si dhe propozon, rialokime të planit buxhetor.
- Përgatit analiza periodike dhe vjetore për realizimin e treguesve ekonomikk dhe financiarë.
- Raporton çdo muaj në formë elektronike dhe shkresore në UMT-ë dhe jashtë radhe për të gjitha të dhënat që kërkohen.
- Është përgjegjës për mbajtjen e librave të llogarisë në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- Është përgjegjëse dhe përgatit të gjithë materilet e nevojshme për kryerjen e inventrëve të përgjithshme dhe periodike për njësinë kryesore
- Koordinon aktivitetin e punës midis specialistëve, cakton detyra dhe ndjek e kontrollon zbatimin e tyre;

- Regjistron të gjitha kontratat e lidhura ndërmjet Njësisëdhe operatorëve ekonomik. Ndjek likuidimin e tyre;
- Detyrat e tjera janë specifikuar në rregulloren e përgjithshme.

Kritere
a. Të ketë përfunduar studimet universitare dhe të jetë i pajisur me diplomë të studimeve "master profesional" në shkencat "ekonomike" apo të barasvlershme me to, sipas kuadrit ligjor të arsimit të lartë;

b. Të ketë mbi 3 vite eksperiencë pune të mëparshme në të njëjtin pozicion ose pozicione të ngjashme;

c. Aftësi të mira kompjuterike, njohja e programeve bazë;

d. Njohuri të gjuhës së huaj anglisht dhe/ose ndonjë gjuhë tjetër.

KRITERET, DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

1. Kërkesat e përgjithshme që duhet të plotësojnë kandidatët për punësim si personel administrativ në UMT janë:
   a) të jetë shtetas shqiptar;
   b) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
   c) të plotësojë kërkesat e posaçme për nivelin e arsimit, përvojës dhe kërkesat e tjera të posaçme për kategorinë, klasën, grupin dhe pozicionin përkatës;
   d) Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtje penale me dashje;
   e) Të mos jetë marrë ndaj tij masa disiplinore, që nuk është shuar sipas ligjit;
   f) Të jetë në kushte shëndetësore të mira për të kryer detyrat përkatëse;
   g) Të ketë vlerësime pozitive të përvojave të mëparshme të punës;
   h) Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur.
2. Në njoftimin për shpalljen e vendit të lirë të punës, në rastin e procedurës së konkurimit (me dosje) të hapur, duhet të përcaktohet:
   a) vendi i lirë i punës;
   b) kërkesat e përgjithshme e të veçanta që duhet të plotësojnë kandidatët, për të marrë pjesë në konkurrim;
   c) kriteret për punësim (arsimi, kualifikimi bazë, kualifikim i veçantë, përvoja në profesion e në drejtim);
   d) lista e dokumentave që duhen paraqitur;
   e) kushtet e punësimit (vendndodhja e punës, kategoria e pagës etj);
   f) afati për paraqitjen e kërkesës;
   g) adresa ku duhet të dërgohet kërkesa.
3. Kërkesa e kandidatit për vendin e lirë të punës duhet të shoqërohet me dokumentat që vërtetojnë plotësimin e kërkesave të paraqitura në njoftimin e publikuar. Dokumentat bazë janë:
   a) Kërkesë me shkrim për aplikim;
   b) Jetëshkrimin (CV) sipas formatit standard (europass);
   c) Fotokopje të pasaportës ose kartës së identitetit;
   d) Kopje e noteruar e diplomës/diplomave dhe/ose njëhsimin e tyre në MAS (për diplomat e

marra jashtë vendit), bashkë me listë notash të noteruara (për ciklet përkatëse të studimit, sipas rastit);
e) Kopje e librezës së punës e noteruar (të gjitha faqet që vëretojnë përvojën në punë);
f) Vërtetim i gjendjes shëndetësore (raport mjekësor për aftësinë në punë);
g) Vërtetim i gjendjes gjyqësore, vetë deklarim sipas formës së kërkuar nga ligji;
h) Vërtetim nga punëdhënës të mëparshëm, që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
i) Dëshmi të njohjes së gjuhës së huaj të noteruar;
j) Dokument tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, apo të tjera të përmendura në jetëshkrim;
k) Referenca nga punëdhënës të mëparshëm, që provojnë vlerësimet pozitive në punë;
l) Dëshmi penaliteti.

4. Kandidatët e interesuar, duhet ta dorëzojnë dokumentacionin e kërkuar origjinal ose të njësuar me origjinalin, brenda 15 (pesëmbëdhjet) ditëve nga shpallja e njoftimit, pranë zyrës së sekretari -arkivës (protokolli), Universiteti i Mjekësisë, Tiranë.

Dokumentacioni i dorëzuar nuk do të kthehet mbrapsht, pasi bëhet pjesë e arkivës së Institucionit. Kandidatët e interesuar, duhet të dorëzojnë dokumentacionin e kërkuar në Sektorin e Protokoll Arkivës, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë (Adresa: Rruga e Dibrës, Nr.371, 1005, Tiranë)

Afati i dorëzimit të dokumentacionit:21.12.2020 – 06.01.2021 (15 ditë).

Përzgjedhja e kandidatit fitues do të bëhet nëpërmjët konkurimit me dosje dhe me intervista të drejtëpërdrejta. Për çdo paqartësi mund të dërgohet email në adresën info@umed.edu.al

A. Fusha e njohurive, aftësive dhe cilësitë të cilat do të zhvillohet intervista:

- Njohuritë mbi Ligjin nr.80/2015 “Per arsimin e larte dhe kerkimin shkencor ne IAL ne RSH”
- Njohuritë mbi Ligjin nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;
- Njohuri mbi ligjin nr. 9936, datë 26.06.2006 “Për menaxhimin e sistemit buxhetorne Rpupliken e Shqiperose”, i ndryshuar;
- Njohuri të akteve nënligjore në fuqi për fushën e procedurave financiare e administrative.

B. Mënyra e vlerësimit:

Në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën.
Në lidhje me intervistën e punës kandidatët do të vlerësohen për njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës; Eksperiencën e tyre të mëparshme; Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

QENDRA KOMBËTARE E URGJENCËS MJEKËSORE

Njoftim per vend te lire pune

Në zbatim të VKM-së nr.176, datë 29.03.2006, “Për botimin e Buletinit të njoftimeve publike”, Urdhrit nr.511, datë 13.12.2011, të Ministrit të Shëndetësisë “Për kriteret e punësimit në Shërbimin

Shëndetësor Publik", të VKM-së nr.933, datë 29.12.2014 "Për miratimin e strukturës organizative të Qendrës Kombëtare të Urgjencës Mjekësore'', të ndryshuar shpall pozicionet vakante për:

- 1 Specialist , në Sektorin e Komunikimit, në Drejtorinë e Komunikimit, Statistikës dhe Regjistrit të Urgjencës.

Kandidatët e interesuar për pozicionin "Specialist" duhet të plotësojnë kërkesat si më poshtë:

- Të ketë mbaruar studimet universitare në një nga degët e Fakultetit të Shkencave Sociale, në një nga Universitetet e Akredituara nga Ministria e Arsimit.
- Të ketë njohuri të mira të gjuhës Angleze.
- Të ketë njohuri të mira kompjuterike.
- Të tregojë gadishmëri dhe përkushtim ndaj punës.
- Të jetë i motivuar për të punuar në grup.
- Të ketë aftësi të mira komunikuese dhe organizative
- Të ketë aftësi shumë të mira mbi kërkimin, mbledhjen dhe përpunimin e informacionit.
- Preferohet të ketë eksperienca të mëparshme pune.

Kandidatët e interesuar për pozicionin "Specialist" duhet të plotësojnë dokumentacionin si më poshtë:

- Diplomë e lëshuar nga Universitetet e Akredituara nga Ministria e Arsimit.
- Listë e notave
- Kërkesën për aplikim në punë
- Jetëshkrimi i kandidatit (CV)
- Kartë Identiteti
- Dëshmi Penaliteti
- Raport mjeko-ligjor
- Librezë e Punës
- Dëshmi të gjuhës së huaj
- Dëshmi të Çertifikatave,trajnimeve, specializimeve, kualifikimeve të ndryshme.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinale ose të noterizuara. Dokumentat do të dorëzohen me zarf të mbyllur.
Dokumentat do të dorëzohen brenda dates 24.12.2020, në adresën Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore, Rr.Lord Bajron Nr.70 Laprakë,Tiranë.

Pas vlerësimit të dokumentacionit kandidatët të cilët i përmbushin kriteret e vendosura më sipër do t'i nënshtrohen një interviste që do të zhvillohet në datë 28.12.2020, ora 10:00 në ambientet e Qendrës Kombëtare të Urgjencës Mjekësore.

UNIVERSITETI I TIRANËS

Njoftim per vend te lire pune

Universiteti i Tiranës shpall konkursin për 2(dy) pozicione vakante për Specialist në Sektorin e Auditimit të Performancës, Drejtoria e Auditit të Brendshëm, Rektorati i Universitetit të Tiranës.

Kandidatët konkurentë për pozicionet vakante Specialist në Sektorin e Auditimit të Performancës, Drejtoria e Auditit të Brendshëm, Rektorati i Universitetit të Tiranës duhet të plotësojnë kriteret si më poshtëcituar:

- Kriteret e përgjithshme:
  a) Të jenë shtetas shqiptar me zotësi të plotë për të vepruar.
  b) Të zotërojnë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin e punës për të cilin konkurojnë.
  c) Të mos jenë dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një vepre penale me dashje.
  d) Të mos jenë marrë ndaj tyre masa disiplinore e largimit nga puna.

- Kriteret e veçanta:

a) Të zotërojnë diplomë të nivelit "Master i Shkencave" ose diploma ekuivalente me to (DIND) në Shkenca Ekonomike ose Juridike.
b) Të kenë të paktën 3 vite eksperiencë pune në fushën e auditit.
c) Të kenë mbrojtur me dëshmi titullin "Auditues i brendshëm në sektorin publik".
d) Të zotërojnë me dëshmi një nga gjuhët perëndimore (Dëshmitë e gjuhëve të huaja perëndimore të noterizuara të jenë sipas testeve të licensuara në Republikën e Shqipërisë, ndërsa për dëshmitë e mbrojtura pranë Fakultetit të Gjuhëve të Huaja të Universitetit të Tiranës, duhet të jenë në formatin orgjinal ose të noterizuar).
e) Të zotërojnë aftësi komunikuese me shkrim (në hartimin e shkresave zyrtare) e me gojë.
f) Të kenë aftësi të mira organizative dhe bashkëpunuese.
g) Të dinë të ruajë konfidencialitetin dhe të kenë etikë të lartë profesionale.

I. Sistemi i vlerësimit është i përbërë prej 100 pikësh, të ndara në: Testimi me shkrim 50 pikë, Dokumentet e dorëzuara 15 pikë dhe Intervista e strukturuar me gojë 35 pikë.
II. Intervista e Komisionit të Vlerësimit të kandidatëve do të bëhet nga Komisioni i ngritur nga Administratori i Universitetit të Tiranës në gjuhën Shqipe. Intervista do të fokusohet në formimin e përgjithshëm, eksperiencat e kandidatit dhe njohuritë në legjislacionin e arsimit të lartë, Ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, si edhe njohuri të akteve nënligjore në fuqi për fushën e arsimit të lartë.

Kandidatët që do të aplikojnë në pozicionet vakante të punës Specialist në Sektorin e Audititimit të Performancës, Drejtoria e Auditit të Brendshëm në Rektoratin e Universitetit të Tiranës do të intervistohen në njohuritë në legjislacionin si më poshtë:

1. Ligji nr. 114/2015 datë 22.10.2015 "Për Auditimin e brendshëm në sektorin publik" ;
2. Ligji nr. 10296 datë 08.07.2010 "Per menaxhimin dhe kontrollin financiar" ;
3. Manuali i Auditimit të Brendshëm ;
4. Udhëzimi nr.12, datë 05.06. 2012 "Mbi procedurat e kryerjes së veprimtarisë së auditimit të brendshëm në sektorin publik" ;
5. Urdhri i Ministrit të Financave nr.69 datë 29.09.2010 "Për miratimin e manualit të procedurave të auditimit të brendshëm" ;
6. V.K.M nr.83, datë 03.02.2016 "Për miratimin e kritereve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik" ;

7. Urdhri i Ministrit të Finanacave nr.86, datë 10.12.2015 "Për miratimin e kodit etik për audituesit e brendshëm në sektorin publik" ;

III. Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë këto dokumenta:
- Kërkesë me shkrim për aplikim;
- Jetëshkrimi (CV);
- Fotokopje e dokumentit të identifikimit;
- Fotokopje e noterizuar e diplomës universitare dhe listës së notave (për diplomat e marrë jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njësimi nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë);
- Fotokopje e librezës së punës (në të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë) e noterizuar;
- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnime, kualifikime, arsimin shtesë etj (nëse ka);
- Dëshmi e penalitetit ose formular vetdeklarimi;
- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- Vlerësim pune nga punëdhënësi i fundit;
- Dëshmi e gjuhës së huaj.

Dokumentacioni i mësipërm të dorëzohet pranë zyrës së Administratorit të Universitetit të Tiranës, në Rektoratin e UT për periudhën duke filluar nga data 21.12.2020-04.01.2021.

INSTITUTI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE

Njoftim per vend te lire pune

Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore, adresa Rruga "Aleksandër Moisiu" Nr. 76 ish Kinostudio "Shqipëria e Re", Tiranë shpall 1 (një) vend të lirë pune në pozicionin:

SPECIALIST
në
SEKTORIN E SEKRETARISË TEKNIKE

KËRKESAT E POZICIONIT TË PUNËS:

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e përgjithshme të pozicionit të punës si vijon:
1) Të kenë shtetësinë shqiptare;
2) Të jenë jo më pak se 18 vjeç;
3) Të gëzojnë zotësi të plotë për të vepruar;
4) Të plotësojë kërkesat për llojin dhe nivelin arsimor, si dhe të zotërojë aftësitë profesionale të domosdoshme, për vendin përkatës të punës, sipas kritereve të miratuara;
5) Të jenë i aftë për punë nga ana shëndetësore;
6) Të mos jenë të dënuar me burg me vendim gjykate të formës së prerë për kryerje të një krimi;
7) Të mos jetë marrë masa disiplinore me largim nga puna, brenda 1 viti nga data e aplikimit.

Kërkesat posaçme të pozicionit të punës:
1. Të zotëroj diplomë të nivelit Bachelor dheMaster Shkencor në Shkencat Juridike.

2. Preferohet të ketë trajnime/kualifikime të ndryshme në fushën e punimeve të ndërtimit/restaurime (shoqëruara me çertifikatë ose diplomë përkatëse).
3. Preferohet të zotërojë një gjuhë të huaj.
4. Preferohet të zotërojë mirë programet Microsoft Ëord, Excel, Poëerpoint.
5. Të ketë aftësi të mira komunikimi individuale dhe në grup.

DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:
1) Kërkesë për aplikim
2) Jetëshkrimi (CV)
3) Fotokopje e Kartës së Identitetit (ID);
4) Fotokopje e diplomës së Shkollës së lartë/Masteri dhe lista e notave e noterizuar;
7) Çertifikata kualifikimi të ndryshme (në rast se ka);
8) Fotokopje e librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë, në rast se ka);
9) Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi (nëse është i punësuar ose ka qenë i punësuar);
10) Raport mjeko-ligjor;
11) Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
12) Dy fotografi (2.5 x 3.5 cm);

Dokumentat duhet të dorëzohen në Zyrën e Protokollit të Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore me adresë: Rr. Aleksandër Moisiu, nr.76, ish Kinostudio, Tiranë, brenda datës 24.12.2020.
Të gjitha dokumentat duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara, dhe të dorëzohen me zarf në zyrën e protokollit të institucionit.

MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Rezultatet për fazën e verifikimit paraprak

Në datën 24.12.2020, Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore do të shpallë listën e kandidatëve që plotësojnë kërkesat e përgjithshme dhe të posaçme për punësim në pozicionin specialist, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë kur do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk plotësojnë kërkesat e përgjithshme dhe kërkesat e posaçme do të njoftohen individualisht nga Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore për shkaqet e moskualifikimit (nëpërmjet adresës së e-mail dhe ose telefon).

PROCEDURA E PËRZGJEDHJES SË KANDIDATËVE:
Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet nga një komision vlerësimi i përbërë nga 3 (tre) veta.
Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është 100 (njëqind), të cilat ndahen:

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar:
a. vlerësimin e jetëshkrimit (CV);
b. vlerësimin e kualifikimeve akademike, profesionale dhe teknike;
c. vlerësimin e trajnimeve;

Pikët totale të vlerësimit të dokumenteve ndahen, si më poshtë:

a. jetëshkrimi, 10 pikë;
b. arsimimi/kualifikimi, 25 pikë;
c. trajnimi, 5 pikë;
Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:
a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me punën;
c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.
Totali i pikëve për këtë vlerësim është 60 pikë.

DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse në Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, do të njoftojë fituesit nëpërmjet adresës së e-mailit. Kandidatët jo fitues kanë të drejtë të ankimohen pranë Sektorit të Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse në Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore. Afati i ankimimit është 2 ditë nga data e shpalljes së rezultateve të konkurimit.

INSTITUTI I FIZIKËS BËRTHAMORE TË ZBATUAR

Njoftim per vend te lire pune

INSTITUTI I FIZIKËS BËRTHAMORE TË ZBATUAR, UNIVERSITETI I TIRANËS, shpall konkursin për dy vende të lira pune, për personel akademik, "Asistent Lektor", në Departamentin e Mbrojtjes nga Rrezatimi dhe Rrjetet e Monitorimit, në Institutin e Fizikes Bërthamore të Zbatuar, Universiteti i Tiranës, sipas drejtimit të mëposhtëm:

- Asistent Lektor në fushën e matjeve radiometrike dhe për rastet e emergjencave radiologjike dhe transportit të materialeve radioaktive.

Kandidatët konkurentë për pozicionin vakant duhet të plotësojnë kriteret si më poshtëcituar:

- Kriteret e përgjithshme:

a) Të kenë diplomën Bachelor dhe Master Shkencor në degën Fizikë në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, të Universitetit të Tiranës, ose në degën Inxhinieri Fizike pranë Fakultetit të Inxhinierisë Fizike dhe Matematike të Universitetit Politeknik të Tiranës, ose në një Universitet në Evropën Perëndimore për të njëjtat degë.
b) Të kenë përfunduar ciklin e parë të studimeve Bachelor me notën mesatare mbi 8.5 dhe ciklin e dytë Master Shkencor me mesataren mbi 9, dhe në rastin e diplomave DIND të kenë përfunduar studimet me notë mesatare mbi 9.
c) Të zotërojnë dëshminë e gjuhës së huaj Anglisht.
d) Të kenë zotësi të plotë për të vepruar.
e) Të zotërojnë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin e punës, për të cilin konkurojnë.
f) Të mos jenë dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një vepre penale me dashje.

g) Të mos jetë marrë ndaj tyre masë disiplinore e largimit nga puna.

- Kritere të veçanta:

